

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

BNT ELECTRONICS

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J61817047D

NUIS/NIPT

Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0689018030

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

042273666

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

financa@bntelectronics.com

E-mail

Administrator Jovan Bojdani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/10/23

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0686079180

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

042273777

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-83327-10-11-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open INT

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

Spitali Universitar i Traumes

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

25133333

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

? LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/11/13

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/11/13

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/84959/10122023

33100000-1

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LPP 162/2020 Per Prokurimin Publik

VKM 285 date 19.05.2021 Per rregullat e Prokurimit Publik

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

□

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Te nderuar !

Ju lutem njihuni me poshte me rrethanat e faktit dhe pretendimet tona ne kete ankese. Rrethanat e faktit:

Ne date 12.10.2023, Spitali Universitar i Traumes ne rolin e Autoritetit Kontraktor ka publikuar proceduren e prokurimit mbi kufirin e larte monetar, me objekt “ Blerje pajisje dhe aparatura mjekesore per SUT” e ndare ne lote. Objekt ankese ne kete procedure eshte “ LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë” parashikuar per tu zhvilluar ne date 13.11.2023. Pasi u njohem me dokumentat e tenderit, konstatuam se specifikimet teknike te hartuara per kete Lot, nuk jane parashikuar sipas parashikimeve ligjore ne fuqi, perkundrazi jane hartuar ne menyre te tille qe kufizojne konkurrencen dhe parapercaktojne operatorin ekonomik fitues.

Referuar LPP 162 “ Per Prokurimin e Publik”, neni 110, afatet per ankim, pika 1 ku parashikon: Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit” Shoqeria BNT Electronics shpk, ankimon sot ne date 23.10.2023 lidhur me dokumentat e tenderit. ( Ankesa jone ploteson kushtin e afatit ligjor pasi afati i fundit bie dt 21, e shtune dhe shtyhet per ditën e punes qe vjen, referuar pikes 8 te po ketij neni ku parashikon “ Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Me poshte detajet e nevojshme:

Ne shtojcen Nr 5, AK ka parashikuar specifikimet teknike te kerkuara per pajisjet qe do te prokuroje dhe per Lotin 1, specifikimet tekjnikë jane si me poshte:

1. Specifikime teknike për Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel të sheshtë:

Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel te sheshte

- Detektor i sheshte = 25 cm x 25 cm
- Tregues lazer i integruar ne detektor i cili prodhon nje kryq
- Madhesia e pikselit = 185 ?m jo me i madh

- Dixhitalizimi = 16 bit jo me i vogel
- Matrica = 1500 x 1400 piksel
- Grilje  $f_0 = 100$  cm
- Mundesi per tre fusha aktive
- Resolucion ne monitor gjate grafise = 3.0 lp/mm ne te tera fushat aktive
- Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise = 3.0 lp/mm ne te tera fushat aktive

#### Tensioni ushqyes i pajisjes

- Tensioni ne hyrje me nje faze 220V

#### Gjeneratori i rrezeve X

- Fuqia maksimale e gjeneratorit = 15 kW
- Generator me frekuence te larte = 50 Hz
- Diapazoni I kV 40 kV to 120 kV ose ekuivalent
- Imazh tek mA: = 35 mA
- Fluoroscopi e vazhdueshme mA: = 15 mA
- Fluoroscopi pulsuese mA: = 20 mA
- Fluoroscopi e vazhdueshme = 30 f/s

#### Llampa e rrezeve X

- Llampe me transformator te tensionit te larte lme dy fokuse
- Tensioni 120 kV
- Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min: = 40,000
- Kapaciteti termik i anodes HU: = 70,000 HU
- Filtrimi i rrezeve X sipas standardit (IEC 601) = 3 mm Al
- Matje e integruar e dozesh per afishimin e prodhimit doze siperfaqe ose vlere kerma ne ajer
- Opsion qe per cdo pacient vlere e akumuluar te ruhet ne databazen e pacienteve
- Kolimator me kolimim pa rrezatim (plumb)

#### Sistemi i C-arm

- Levizje orbitale = 140 °
- Pjerresim = (? 220 °)
- Levizja horizontale = 20 cm
- Levizja vertikale = 40 cm e motorizuar

#### Monitor sekondar i montuar ne C-ARM

- Monitor me prekje = 10 inch
- Monitor me ngjyra me ndricim te larte

#### Afishues/ Monitore

- Monitor me ngjyra me ndricim te larte 2x19" (48 cm) ose nje monitor = 40
- Diagonalja e ekranit = 19" (48 cm)
- Shfaqja e imazhit 1280x1024 (pixels)
- Ndricimi maksimal 650 cd/m<sup>2</sup>
- Raporti i kontrastit = 700:1
- Teknologjia e preferuar LED me ndricim te pasem
- Kendi i shikimit horizontal / vertikale 178 ° / 178 °

#### Kareli i levizshem i monitoreve

- Mundesi per instalimin e dy monitoreve ose nje monitor = 40
- Dalje USB per te dhenat: USB 2.0
- Nderfaqja Audio (Aux In) dhe Sistem te intergruar te zerit me altoparlant dhe nderfaqje
- Lidhje LAN Gigabit
- WLAN / WiFi 150 Mbit/s IEEE 802.11 a, b, g, n
- Kabell fuqie = 5 m

#### Hardware i PC

- Sistem operacional me 64 bit

- RAM = 8 GB
- Karte grafike e nivelit profesional e performances se larte for sistemin e detektorit te rrezeve X
- Kapacitet ruajtes per = 100,000 imazhe ne hard disk, pavaresisht nga madhesia e matrices
- Te gjithë pacientet e ruajtur ne foldera te vecante
- Memorie HDD = 2 TB

#### Administrimi i te dhenave te pacientit

- Mundesi (HIS/RIS) per marrjen e te dhenave te ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia
- Regjistrim i pacientit te emergjences
- Administrim i studimeve dhe i te dhenave te imazhit
- Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital
- Programe te dedikuara me doze te ulet
- “Filter shtese bakri ose alumini per reduktim te metejshem te dozës se pacientit”

#### Shfaqja e imazhit

- Shfaqje e imazhit 1k x 1k
- Diafragma dixhitale
- Zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks
- Rrotullim dixhital i imazhit
- Zoom I detektorit
- LSH (Last Scene Hold)
- Invertim i imazhit horizontal dhe vertikal
- Invertim i imazhit Positiv/negativ
- Rilujtje e videove of scenes dhe funksion automatik i rilujtjes.

#### Perpunimi i imazhit

- Korrektim i metalit
- Filtrim për shfaqjen e imazheve me konture te theksuara
- Theksim i kontureve
- Reduktim i zhurmes
- Optimizim dixhital i dendesise
- Shenim R/L
- Matje te distances dhe te këndit

#### Programe dhe hardware te vecanta te kërkua

- Digital Subtraction Angiography (DSA) te perfshihet
- Perfetim i imazhit ne Subtraction Angiography (SUB) dhe roadmap (ROAD)
- Teknike Roadmap per udhezim te lehte te kateterit, dilatacionit, dhe vendosjes se stenteve
- Perfetim i imazhit deri 30 f/s
- Percaktim i vlerave gjeometrike dhe te dendesise.
- Mbivendosje grafike ne kohe reale
- Opsion i zhvendosjes se pikseleve
- Funksion i matjeve 2D: matje te kendeve dhe distancave.
- Nderfaqje per injector kontrasti per idhjen e nje injektorit kontrasti
- Kerkese automatike per injektim kontrasti pas marrjes se imazhit
- Shfaqje e ndryshimeve dinamike gjate injektimit te kontrastit
- Celes pedal per leshimin e rrezatimit
- Regjistrues CD / DVD per serite e imazheve dhe fluoroskopine ne regjistrues DVD
- DICOM Standard
- DICOM Printim

Garancia: Jo më pak se 1 (Një) Vit.

Sasia: 2 Copë

Ne karakteristikat teknike te Gjeneratorit me Rreze X te kesaj pajisje jane parashikuar 2 elemente teper te rendesishem te cilet behen shkak per kufizimin e konkuresces pasi keto karakteristika i perkasin nje prodhuesi te percaktuar dhe konkretisht GE. Specifikimet teknike ne fjale jane:

- Generator me frekuence te larte  
= 50 Hz

- Fluoroskopi e vazhdueshme mA: = 15 mA

Fillimisht, risjellim ne vemendjen tuaj se firmat prodhuese kryesore ne fushen e prodhimit te pajisjeve mjekesore qe jane boterisht te njohura jane vetem 5 -6. Te gjitha prodhojne pajisje te te njejtit nivel por qe secili nga keto prodhues ka perdorur disa "elemente" te vecante si specifikime teknike qe kane disa specifikimet te tyre te ndryshme nga njera tjetra dhe qe per pasoje bejne dallimin. (Kete ceshtje "vecorive" teknike qe ka secili prodhues e kemi trajtuar edhe me perpara ne ankesat tona ku ju kemi bere me dije se si vetem nje specifikim teknik nga 100 te tjera te parashikuara, automatikisht determinon prodhuesin dhe per pasoje fituesi e nje procedure te caktuar).

Ne rastin konkret, nenvizojme faktin se pasi analizuam me kujdes specifikimet teknike te kesaj pajisje, konstatoam se "vecorite" (gjenerator me frekuence = 50 Hz dhe Fluoroskopi e vazhdueshme mA: = 15 mA) perkasin nje produkti /brandi te caktuar, konkretisht brandi GE (General Electric Healthcare).

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar specifikimeve teknike qe i referohen nje prodhuesi te caktuar ne kundershtim me LPP, Neni 3, Parime te Pergjithshme ku parashikon:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Parashikimi i kriterëve teknike qe I referohen nje prodhuesi eshte gjithashtu ne kundershtim me LPP, neni 36 "Specifikimet teknike" pika 2 ku parashikon "Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik". Gjithashtu jane ne kundershtim me piken 3 ku parashikon:

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Ne rastin konkret, AK nuk ka zbatuar asnjeren prej metodave pasi sic edhe kemi parashtruar ne ankesat tona te meparshme per pajisjet mjekesore nuk ka nje standart as kombetar as nderkombetar qe mund te zbatohet pasi nuk eshte miratuar nje standart qe duhet ti permbahen AK por keto pajisje duhet te prokurohen sipas gemes a) te pikes 3 te ketij neni, pra sipas kerkesave funksionale ose te performancës.

Duke vendosur kerkesat per Generator me frekuence te larte = 50 Hz dhe Fluoroskopi e vazhdueshme mA: = 15 mA, AK ka kufizuar pjesemarrjen e operatoreve te tjere ekonomik te cilet mund te ofrojne kerkesa funksionale dhe performancen e kerkuar me frekuence gjeneratori dhe Fluoroskopi qe shprehet ne vlera te tjera por arrin performancen e kerkuar apo me te larte se sa eshte kerkuar.

Parashikimi i specifikimeve teknike qe i drejtohen nje prodhuesi jane diskriminuese qe cojne ne mungese te konkureses dhe ne dem ekonomik per buxhetin e shtetit. Diskriminojne operoret e tjete te interesuar si dhe cenojne integritetin, besimin dhe transparencen publike

Ky veprim vjen ne shkelje te vete qellimit te Ligjit te Prokurimit Publik ku parashikon :

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficiency dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve per kualifikim krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se kerkesat per kualifikim si dhe specifikimet teknike te cilat edhe keto duhet plotesuar per tu kualifikuar, duhen bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke patur parasysh edhe lidhjen e drejteperdrejte me objektin dhe natyren e kontrates.

Si perfundim kerkojme: ndryshimin e dokumentave te tenderit perkatesisht specifikimeve teknike te behen te hapura si me poshte dhe te lihet e hapur:  
Generator me frekuence te larte = 40 Hz .

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

## 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo e aplikueshme ne kete rast

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

jo e aplikueshme ne kete rast

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:** 042273666

**E-mail:** [financa@bntelectronics.com](mailto:financa@bntelectronics.com)

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar** Jovan Bojdani